



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Harst Group" Sh.P.K. të datës 23.08.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 18.08.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Renovimi dhe përmisimi i infrastrukturës së objekteve të KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-4220-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Harst Group" Sh.P.K. e datës 23.08.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 18.08.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Renovimi dhe përmisimi i infrastrukturës së objekteve të KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-4220-5-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "Harst Group" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Harst Group" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 23.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 18.08.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Renovimi dhe përmisimi i infrastrukturës së objekteve të KPSH-së" me nr. të prokurimit 616-23-4220-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

- **Pretendimi ankimor nr. 1** - "në kërkesën e datës 06.08.2023, përveç që nuk trajtoni pretendimet tona, fare nuk nxjerrni vendim ndaj kërkesës për ri shqyrtim".
- **Pretendimi ankimor nr. 2** - "Arsyetimi i anulimit lidhur me gabimet e potencuar nga ju si AK, ne paramane dhe pohimi se mund të pamundësojnë që tenderuesit të ofertojnë me çmime adekuate dhe pamundësimi i vlerësimit të drejte ne këtë faze të prokurimit është i kundërligjshëm".

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 1 – sipas të cilit parashtruesi pretendon që autoriteti kontraktues nuk ka marrë vendim lidhur me kërkesën për rishqyrtim të datës 06.08.2023, duhet theksuar se përmes sistemit e-prokurimi mund të evidentohet se parashtruesi me datë 07.08.2023 në ora 15:19 ka ngarkuar një kërkesë për rishqyrtim lidhur me këtë aktivitet të prokurimit (dhe jo me datë 06.08.2023 siç pretendon parashtruesi). Lidhur me këtë kërkesë për rishqyrtim autoriteti kontraktues duke u bazuar në LPP dhe RRPP brenda afatit ligjor me datë 14.08.2023 në ora 14:16 e ka ngarkuar në sistemin e-prokurimi vendimin. Për më tepër autoriteti kontraktues përmes këtij vendimi e ka miratuar si pjesërisht të bazuar kërkesën për rishqyrtim të parashtruesit ashtu që e ka kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit. **Rrjedhimisht ky pretendim ankimor është i pabazuar në tërësi.**

Vlen të shtohet se me datë 18.08.2023 është pranuar edhe raporti i komisionit për rivlerësim ku është rekomanduar anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit me arsyet e evidentuara në njoftimin mbi vendimin si dhe është rekomanduar që bazuar në nevojat eventuale të njësisë kërkuese të bëhet edhe ritenderimi pas korrigjimit të paramasës.

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 2 – sipas të cilit parashtruesi e kundërshton arsyen për anulimin e aktivitetit të prokurimit, fillimisht duhet theksuar se ky aktivitet i prokurimit është anuluar për shkak të gabimeve në paramasën e publikuar në sistemin e-prokurimi të cilat gabime janë lëshuar nga vet autoriteti kontraktues. Duhet potencuar faktin se në kërkesën për rishqyrtim të datës 07.08.2023 vet parashtruesi i ka identifikuar këto gabime në paramasë dhe pikërisht ky pretendim i tij është miratuar si i bazuar përmes vendimit të autoritetit kontraktues të datës 14.08.2023. Mirëpo edhe në kërkesën aktuale për rishqyrtim parashtruesi askund nuk e mohon faktin se ekzistojnë gabime në paramasë. Përkundrazi e konfirmon këtë fakt përmes pretendimit të dytë. Megjithatë parashtruesi aludon se tani në këtë fazë këto gabime në paramasë janë të parëndësishme. Prandaj duhet theksuar faktin se autoriteti kontraktues e ka miratuar si të bazuar pjesërisht kërkesën për rishqyrtim të parashtruesit të datës 07.08.2023 pikërisht duke u referuar te gabimet dhe ndërhyrjet në paramasë (të cilat nga vet parashtruesi janë prezantuar atëherë si mjaft të rëndësishme dhe si shkelje ligjore të patejkalueshme). Në anën tjetër për të njëjtën çështje tanimë parashtruesi aludon se këto gabime qenkan të parëndësishme. Për këto arsye pretendimi i dytë i parashtruesit parimisht është mjaft kundërtëhënës. Për më tepër duhet pasur parasysh edhe faktin se arsyet për eliminimin e këtij aktiviteti të prokurimit janë evidentuar pikërisht nga procesi i rivlerësimit të cilin e ka kërkuar vet parashtruesi përmes kërkesës për rishqyrtim të datës 07.08.2023.


Sidoqoftë, autoriteti kontraktues konsideron se nuk është aspak kontestues fakti se ekzistojnë gabime në paramasë. Konkretisht në rubrikën 4.6 dhe 4.7 të paramasës mungojnë sasitë e përcaktuara për të cilat duhet të ofertohen çmimet nga tenderuesit (pra nuk është përcaktuar se për çfarë sasie duhet të ofrohet çmimi përkatës nga tenderuesit). Sipas nenit 62 paragrafit 1 nënparagrafit 1 të LPP përcaktohet se autoriteti kontraktues mund të përfundoj një aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultoj në dhënien e kontratës nëse ka ndodhur “një shkelje e ligjit aktual, ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit e cila nuk mund të rregullohet apo parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit...”. Ngjashëm edhe përmes nenit 43 paragrafit 43.5 nënparagrafit i) të RRPP përcaktohet se procedura e prokurimit duhet të anulohet pas hapjes së ofertave nëse “një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi”. Në rastin konkret shkeljet e ligjit të cilave ju referohen dispozitat e cituara më sipër mund të jenë të ndërlidhura me nenin 27 dhe 28 lidhur me nenin 1, 6 dhe 7 të LPP si dhe me nenin 10 paragrafin 10.1 nënparagrafin b) dhe nenin 11 paragrafin 11.1 nënparagrafin f) të RRPP. Konkretisht gabimet e evidentuara në paramasë si të tilla mund të bëjnë që paramasa të mos jetë në përputhje me standardet e përcaktuara nga LPP dhe RRPP pasi që në mungesë të sasive të përcaktuara në rubrikën 4.6 dhe 4.7 mund të pamundësojnë që tenderuesit të ofertojnë me çmime adekuate dhe rrjedhimisht e pamundësojnë që vlerësimi i tenderëve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe sipas parimeve për mos diskriminim/favorizim, ekonomikitet dhe efikasitet. Duke marrë parasysh këtë gjendje faktike si më sipër, rekomandimi i komisionit vlerësues për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit është i mbështetur plotësisht nga dispozitat e sipërcituara të LPP dhe RRPP. Prandaj edhe pretendimi i dytë është i pabazuar në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij akti vendimi.

Prishtinë, 28.08.2023


Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komunë e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.